



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 183 Prot.

Tiranë, më datë 18.03.2022

VENDIM
Nr. 54, datë 18.03.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.03.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Konceptit të Sondazheve Arkeologjike i realizuar nga individi i licensuar në arkeologji Z. Ylli Cerova, në kuadër të projektit “Godinë banimi I kat mbi tokë, lagjja nr.14, Rr. ‘Mbreti Pirro’, Nr.46, Durrës”, brenda kufirit Zonë Arkeologjike “B”, të qytetit të Durrësit, me aplikues Ermir Shera dhe zhvillues Mark Shtjefni;
 2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji I cili do të realizojë sondazhin arkeologjik në kuadër të projektit “Godinë banimi I kat mbi tokë, lagjja nr.14, rr. ‘Mbreti Pirro’, nr.46, Durrës”, brenda kufirit Zonë Arkeologjike “B”, të qytetit të Durrësit, si dhe Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikim dhe zhvillimin e territorit
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrative.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

